



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje lubrifikante (vajra, graso, filtra, etj) për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): (CPV): 429133000-2 Filtra vaji, (CPV): 42913400-3 Filtra nafte, (CPV): 42514310-8 Filtra ajri, (CPV): 24951100-6 Lubrifikantët, (CPV): 24951000-5 Graso dhe Lubrifikantë, (CPV): 09211500-6 Vajra reduktori, (CPV): 09211100-2 Vajra motorike.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,463,700 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë pa Tvsh, nga e cila: 1,685,267 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh nga Granti dhe 778,433 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh nga të ardhurat e Bashkisë Divjakë, i ndarë si mëposhtë:

- **Bashkia:** 1,666,550 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh nga e cila: 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 416,550 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh nga të ardhurat e Bashkisë Divjakë.
 - **Spektori Ujitje-Kullim:** 582,950 (pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh nga e cila: 221,067 (dyqind e njëzetë e një mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 361,883 (treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga të ardhurat e Bashkisë Divjakë.
 - **Spektori i Sektori Shërbimeve Turistike:** 214,200 (dyqind e katërmëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa Tvsh nga Granti.
- Burimi i financimit:** Granti dhe Të ardhurat e Bashkisë Divjakë.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bere që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto

rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë ne vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e

sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Licencë të tregtimit me pakicë ose shumicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë nga organet kompetente ose Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 5, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.* Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu, kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Raport analiza të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose dhe Laborator i Akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar të Akreditimit për produktet si më poshtë: Vaj motori 15W-40, Vaj motorri 20W-50 ;Vaj reduktori 80W-90; Vaj Hidrauliku ISO VG 46; Vaj Hidrauliku ISO 68; Graso EP -2 Lithium,Graso Kalcium,Vaj Motorri 10W-40 ku vlerat e raport Analizave të jenë brenda kufijve të vlerave të kërkuara ne shtojcen Specifikime Teknike të DST të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të sjellë, autorizim nga prodhuesi për mallrat e importuar nga jashtë, me të dhënat përkatëse të prodhuesit, si dhe të dhënat e të autorizuarit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë katalog të zërave për produktet si më poshtë: Vaj Motori 15W-40, Vaj Motorri 20W-50 ; Vaj Reduktori 80W-90; Vaj Hidrauliku ISO VG 46; Vaj Hidrauliku ISO 68; Vaj Motorri 10W-40 , Vaj Motorri 10W-40 për kamiona, Vaj kambio ATF , Vaj transmisioni 75W-90, Graso EP -2 Lithium, Graso me bazë Calcium, Adblue , Antifrizë, Alkol Frenash, Vaj 10W-30 (motorr uji), Vaj Kamjo 80W-90 API GL-5, Vaj motorri 10W30, Vaj Transmisioni TDTO 30, Vaj Transmisioni TDTO 50, Vaj Transmisioni MTO, nga furnitori i tij dhe nëse është prodhues të sjellë katalogun e tij, ku të jepen treguesit e vlerave teknike, nëse i plotësojnë kushtet e kërkuara dhe specifikimet teknike të produkteve në katalog të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë. (Katalogjet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 6, gërma b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme:
Certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).
Certifikatën e cilësisë ISO 14001:2015 (Standart për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit).

(Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë)

Argumentimi: Në bazë të nenit 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar ” dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me te, pasi blerja e këtij malli ka

impakt mbi mjedisin, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Ky kriter është ne perputhje me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1, ku përcaktohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të cilës, merr përsipër të kryejë furnizimin dhe shërbimin e transportit të mallit të kërkuar në objekt, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.8 Ofertuesi duhet të deklarojë se është i gatshëm për t’ju përgjigjur çdo nevojë emergjente për mallrat të paraqitur nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

E. Karakteristikat dhe specifikimet teknike të mallrave (lubrifikantëve dhe antifrizës)

***Vaj motori 15W-40 me specifikime API CF-4/CF/SH, ACEA E-2, ose API CG-4/CF-4/CF/SH, ACEA E-2**

Densiteti 15 °C	(0.870 ÷ 0.890)	g/ml
Viskoziteti kinematik në 40 °C	(100 ÷ 117)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik në 100 °C	(12.5 ÷ 16.3)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(139 ÷ 155)	
Pika e flakerimit °C	(220 ÷ 260)	°C

*** Vaj motorri 20W-50 me specifikime API CF-4/CF/SG**

Densiteti 15 °C	(0.865÷0.899)	g/ml
Viskoziteti kinematik me 40 °C	(125 ÷ 180)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100 °C	(16.3 ÷ 21.9)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(128 ÷ 155)	
Pika e flakerimit °C	(220 ÷ 255)	°C

***Vaj motorri 10W30 me specifikime API CI-4, ACEA E 7**

Densiteti 15°C	(0.865÷ 0.890)	g/ml
Viskoziteti kinematik në 40°C	(70 ÷ 90)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100°C	(9.5 ÷ 12.5)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(120 ÷ 145)	

Pika e flakerimit °C (220÷240) °C

***Vaj reduktori 80W-90 me specifikime API GL-4**

Densiteti 15 °C	(0.850÷0.898)	g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40 °C	(140÷170)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100 °C	(14.5÷16.7)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(95÷125)	
Pika e flakerimit °C	(220 ÷245)	°C

***Vaj Hidrauliku ISO VG 46 me specifikime DIN 51524 Part II, Vickers HP Vane Pump Tests,M -2950 S,I-286S ,Cincinnati Milacron P-68,P-69,P-70.**

Densiteti 15°C	(0.860÷0.890)	g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40°C	(45÷47.7)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100°C	(6.6 ÷ 9.2)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(90 ÷ 130)	
Pika e flakerimit °C	(220÷245)	°C

***Vaj Hidrauliku ISO 68 me specifikime DIN 51524 Part II, Vickers HP Vane Pump Tests,M -2950 S, I-286S ,Cincinnati Milacron P-68,P-69,P-70.**

Densiteti 15 °C	(0.875÷0.892)	g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40 °C	(65-68.9)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100 °C	(8.6÷9.5)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(100÷ 120)	
Pika e flakerimit °C	(220÷245)	°C

*** Vaj Motorri 10W-40 me specifikime API SL/CF**

Densiteti 15°C	(0.860÷ 0.890)	g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40°C	(85 ÷ 95)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100°C	(12.5 ÷ 16.3)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(140 ÷ 168)	
Pika e flakerimit °C	(220÷238)	°C

*** Vaj Motorri 10W-40 për Kamionë me specifikime API CI-4**

Densiteti 15°C	(0.860÷ 0.890)	g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40°C	(90 ÷ 110)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100°C	(12.5 ÷ 16.3)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(140 ÷ 165)	
Pika e flakerimit °C	(220÷238)	°C

*** Vaj kambio ATF me specifikime GM Dexron II ,MAN-339,MB 236.1**

Densiteti 15 °C	(0.860÷0.880) g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40 °C	(34-38) mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100 °C	(7÷8) mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(160÷ 180)
Pika e flakerimit °C	(195÷220) °C

***Vaj reduktori 75W-90 me specifikime API GL-5**

Densiteti 15 °C	(0.850÷0.870) g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40 °C	(90÷120) mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100 °C	(14.5÷16.7) mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(150÷180)
Pika e flakerimit °C	(200 ÷230) °C

***Graso lithium EP-2:**

Pika e pikimit °C	(170 ÷210)
Penetracioni 25°C	(240÷285)

***Graso Kalcium :**

Pika e pikimit °C	(90 ÷ 130)
Penetracioni 25°C	(220÷260)

***Adblue me specifikime DIN 70070**

Densiteti 20 °C	(1.087÷1.093) g/ml
Permbajtja e Urese % mm	(31.8÷ 33.2) % mm
Biuret	(max 0.3) % mm
Indeksi Rekreativ	(1.3814 ÷1.3843)

***Antifriz me specifikime ASTM D-3306, TS 3582, SAE J 1034**

Densiteti 15 °C	(1.06÷1.085) g/ml
Pika e Vlimit °C	(100÷120) °C
PH ne 33% volum uji	(9 ÷11)

***Alkol Frenash me specifikime SAE J 1703 FMVSS 116**

Densiteti 15 °C	(1.06÷1.085) g/ml
Viskoziteti kinematik 100°C	(1.5÷ 1.7) mm ² /s
Pika e Vlimit °C	(220÷240) °C

***Vaj Motorri 10W-30 (motorr uji) me specifikime NMMA FC-W**

Densiteti 15 °C	(0.850÷0.870) g/ml
-----------------	--------------------

Viskoziteti kinematik 100°C	(9.5 ÷ 12)	mm ² /s
Pika e flakerimit °C	(230÷240)	°C

***Vaj reduktori 80W-90 me specifikime API GL 5**

Densiteti 15 °C	(0.870÷0.900)	g/ml
Viskoziteti kinematik ne 40 °C	(140÷160)	mm ² /s
Viskoziteti kinematik 100 °C	(14.0÷16.0)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(95÷120)	
Pika e flakerimit °C	(220 ÷240)	°C

***Vaj Transmisioni TDTO 30 me specifikime API CF-2, Allison C-4, CAT TO-4**

Densiteti 15°C	(0.880÷ 0.990)	g/ml	
Viskoziteti kinematik ne 40°C	(100 ÷ 115)	mm ² /s	
Viskoziteti kinematik 100°C		(10 ÷ 13)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(95 ÷ 120)		
Pika e flakerimit °C	(240÷260)	°C	

***Vaj Transmisioni TDTO 50 me specifikime API CF-2, Allison C-4, CAT TO-4**

Densiteti 15°C	(0.880÷ 0.990)	g/ml	
Viskoziteti kinematik ne 40°C	(200 ÷ 220)	mm ² /s	
Viskoziteti kinematik 100°C		(17 ÷ 20)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(90 ÷ 120)		
Pika e flakerimit °C	(250÷270)	°C	

*** Vaj Transmisioni MTO me specifikime API GL-4, Allison C-4, Ford M2C 134D, John Dere J20C, Massey Ferguson CMS M1143,M1145.**

Densiteti 15°C	(0.860÷ 0.890)	g/ml	
Viskoziteti kinematik ne 40°C	(50 ÷ 68)	mm ² /s	
Viskoziteti kinematik 100°C		(9.5 ÷ 10.8)	mm ² /s
Indeksi i viskozitetit	(140 ÷ 185)		
Pika e flakerimit °C	(220÷230)	°C	

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushes , duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor , ne perputhje me percaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, date 19.05.2021 “ Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar , Neni 12 , Neni 13 dhe Neni 76

Shenime:

1-Te gjitha materialet e paraqitura ne preventiv , te jene ne perputhje te plote me kerkesat e cdo tipi mjeteve te makinerise se rende (ekskavatoreve) dhe mjeteve te transportit .

*** Shënim: Në respektim të nenit 36 të LPP-së, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”**

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit **SSH/EN/ISO**, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërish të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT